

Rregullore për organizimin dhe funksionimin e këshillave komunitare.

- ✚ Në Qytetin Vau-Dejës në bazë të iniciativës qytetare janë ngritur dhe funksionojnë këshillat komunitarë të lagjeve. Këshillat përbëhen nga banorë të lagjes dhe janë organizuar mbi baza vullnetare.
- ✚ Këshilli bashkiak ka përcaktuar rregullat e përgjithshme të organizimit dhe funksionimit të këshillave komunitare të lagjeve dhe marrëdhëniet që ato kanë me bashkinë dhe me strukturën e saj.
- ✚ Këshillat komunitar mbështesin funksionet qeverisëse të bashkisë në lagjen apo qytetin e tyre dhe mund të zbatojnë projekte në dobi dhe përfitim të komunitetit.
- ✚ Këshillat komunitarë, në bazë të vendimeve të këshillit bashkiak, kanë të drejtë të kryejnë funksione dhe kompetenca të caktuara që mund tu delegohen nga këshilli.
- ✚ Këshillat komunitare mund të shpërblehen për punën që kryejnë, sipas kritereve të përcaktuara nga këshilli bashkiak , në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- ✚ Detyrat më të hollësishme të tyre janë përcaktuar në rregulloren e këshillit bashkiak.